



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

**Drejtuar :** Bashkimit të operatorëve ekonomik “I 2 A” shpk & “VALONA KONSTRUKSION” shpk

**Adresa:** Njësia administrative Bërçullë , Zona Kadastrale Nr. 1167, Pasuria Nr.700 Tirane  
Lagjia Uji i Ftohtë, në perëndim të rrugës Vlorë – Orikum, në kufi me rezidencën Qeveritare,  
Vlorë.

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e Hapur**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **Nr.REF-70105-05-23-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Ndërtim çati e re për Konviktin Ekonomik, Bashkia Tiranë”**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): **Buletini i Njoftimeve Publike Nr.47, datë 29 Maj 2023**

**Buletini i Njoftimeve Publike Nr.47, datë 29 Maj 2023**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “EURONDËRTIMI 2000” shpk** **NIPT- K02003001A**

Vlera totale e ofertes pa TVSH = 27.313.292,48 (njëzet e shtatë milion e treqind e trembëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy presje dyzetetetë) lekë.

**2. Operatori ekonomik “INERTI” shpk** **NIPT- J66926804L**

Vlera totale e ofertes pa TVSH = 22.152.301,50 (njëzet e dymilion e njëqind e pesëdhjetë e dymijë e treqind e një presje pesëdhjetë) lekë.

**3. Operatori ekonomik “NDËRTIMI” shpk** **NIPT- K11325002C**

Vlera totale e ofertes pa TVSH = 33.148.085 (tridhjetë e tremilion e njëqind e dyzet e tetë mijë e tetëdhjetë e pesë) lekë.

**4. Operatori ekonomik “RAFIN COMPANY” shpk** **NIPT- K11325002C**

Vlera totale e ofertes pa TVSH = 33.036.203 (tridhjetë e tremilion e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tre) lekë.

**5. Operatori ekonomik “UDHA” shpk** **NIPT- K77524909Q**

Vlera totale e ofertes pa TVSH = 34.164.561 (tridhjetë e katërmilion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një ) lekë

**6. Bashkimi i operatorëve ekonomik “I 2 A” shpk & “VALONA KONSTRUKSION” shpk “I 2 A” shpk NIPT- M11630006B & VALONA KONSTRUKSION NIPT- K26330202E**

Vlera totale e ofertes pa TVSH = 32.402.654 (tridhjetë dymilion e katërqind e dymijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër) lek.

**7. Bashkimi i operatorëve ekonomik “LIS Konstruksion” shpk & “Viante Konstruksion” shpk Lis Konstruksion NIPT- K66613407H & Viante Konstruksion NIPT-K47103804L**

Vlera totale e ofertës pa TVSH = 34.890.051 (tridhjetë e katërmilion e tetëqind e nëntëdhjetëmijë e pesëdhjetë) lekë

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**I. Operatori ekonomik “EURONDËRTIMI 2000” shpk NIPT- K02003001A**

**1. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale”, pika 2.1.3 përcaktohet kriteri si më poshtë:**

**2.1.3** Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e licensimit (QKL) Kodi III.2. B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane”. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor të mbetjeve te ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqipërisë”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik konstatohet se në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur kontratë shërbimi Nr.2514 Rep, Nr.1816 Kol, datë 24.03.2021 të lidhur me shoqërinë “Everest” shpk. Gjithashtu shoqëria “Everest” shpk ka paraqitur dhe një deklaratë angazhimi për realizimin e shërbimit. Sjellim në vëmendje të operatorit ekonomik nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se:

1. *Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.*

2. *Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.*

3. *Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

4. *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.*

5. *Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.* 6. *Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.*

7. *Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.*

Gjithashtu ne nenin 90 pika 2 të VKM 285, datë 19.05.2021 përcaktohet shprehimisht se:

Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- **ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;**
- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.

- *t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.*

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

Në rastin konkret, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "EURONDËRTIMI 2000" shpk në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur në ditën e hapjes së ofertave kontratën e shërbimit të lidhur me subjektin "Everest" shpk dhe deklaratën e angazhimit të subjektit që e mbështet në kuptim të dispozitës ligjore sa më sipër. Por subjektin nuk e ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit si subjekt mbështetës dhe gjithashtu nuk ka provuar se për subjektin aftësinë e të cilit shfrytëzon nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

Referuar shtojcës 8 të dokumentave standarte të tenderit "Formulari përmbledhës I vetdeklarimit" përcaktohet se:

- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*

Në interpretim të Nenit 84 të LPP operatori ekonomik me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor referuar kuadrin ligjor në fuqi mund të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera. Sa më sipër sqarohet se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Gjithashtu sqarohet se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, vërehet, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "EURONDËRTIMI 2000" shpk nuk është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik.

## **2. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.3.9, përcaktohet kriteri si më poshtë:**

**2.3.9** Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues për materialet (*bojë akrilike, bojë plastike, stuko, llaç i gatshëm, kartonxhes, kabull elektrik 3x1.5, katrama, tjegulla*), të pasqyruara në Shtojcën 5 "Formulari i specifikimeve teknike", duhet të paraqesë: Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve të prodhuesit/distributorëve zyrtarë ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit/ distributorët zyrtarë, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mallrave sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.9) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Nga verifikimi në Sistemin e prokurimit elektronik të Formularit përmbledhës të vetdeklarimit shtojca 8 të paraqitur nga operatori ekonomik "Eurondërtim 2000" shpk si dhe nga verifikimi i dokumentacionit në tërësi konstatohet se në lidhje me këtë kriter operatori ekonomik nuk ka vetdeklaruar në shtojcën 8 dhe nuk ka bërë asnjë deklaratë të administratorit ku të japë informacion apo të deklarojë nën përgjegjësinë e tij se mallrat të cilat do të përdoren për realizimin e punëve plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

*Sa më sipër operatori ekonomik nuk plotëson kriterin sipas pikës 2.3.9 të përcaktuar në kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik.*

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “EURONDËRTIMI 2000” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura duke e shpallur ofertë të pavlefshme.

## **II. Operatori ekonomik “NDËRTIMI” shpk**

**NIPT- K11325002C**

### **1. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale”, pika 2.1.3 përcaktohet kriteri si më poshtë:**

2.1.3 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombëtare e licensimit (QKL) Kodi III.2. B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane”. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor të mbetjeve te ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqipërisë”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Ndërtimi”shpk konstatohet se nuk ka paraqitur licencën sa më sipër kërkuar duke mos plotësuar kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti profesional pika 2.1.3.

### **2. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e vecanta për kualifikim”, pika 2.3.3 përcaktohet kriteri si më poshtë:**

**2.3.3** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- b) Diplomë

*(Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës se preventivit të punimeve që ka marre persiper sipas përqindjes së bashkepunitimit).*

**Shënim:** Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

*Nga verifikimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik "Ndërtimi" shpk konstatohet se nuk ka paraqitur deklaratën nga administratori i shoqërisë për drejtuesin teknik të punimeve në objekt duke mos plotësuar "kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.3.*

**3. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 "Kriteret e vecanta për kualifikim", pika 2.3.4 përcaktohet kriteri si më poshtë:**

**2.3.4.** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik në liçencë për këtë objekt specialistët si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi.
- 1 (një) Inxhinier Elektrik.

Për specialistet e mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme
- Diplomë
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shkurt 2023 - Prill 2023.

***Shënim:** Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

Sa më sipër Komisioni i vlersimit të ofertave pas shqyrtimit të vetdeklarimit të bërë nga subjekti mbështetës "Ndërtimi" shpk konstaton se nuk ka vetdeklaruar drejtuesin Teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë respektivisht inxhinier ndertimi dhe inxhinier elektrik duke mos plotësuar "Kriteret e vecanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik pika 2.3.4.

**4. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 "Kriteret e veçanta për kualifikim", pika 2.3.5 përcaktohet kriteri si më poshtë:**

**2.3.5** Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **92 (nëntëdhjetë e dy) punonjës** për periudhën 3(tre) muaj **Shkurt 2023–Prill 2023**. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën **Shkurt 2023–Prill 2023**.
- b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Shkurt 2023–Prill 2023**.

***Shënim:** Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

*Nga verifikimi në Sistemin e prokurimit elektronik te Formularit përmbledhës të vetdeklarimit shtojca 8 të paraqitur nga operatori ekonomik Ndërtimi shpk konstatohet se operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 14 punonjës duke mos plotësuar numrin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit prej 92 punonjës.*

Në nenin 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se informacioni që duhet të përmbajë formulari përmbledhës i vetdeklarimit duhet të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

Sa më sipër komisioni i vlersimit të ofertave pas shqyrtimit të vetdeklarimit të bërë nga operatori ekonomik në lidhje me numrin e punonjësve të cilët do ti vihen në dispozicion autoritetit kontraktor për realizimin e kontratës konstaton se operatori ekonomik nuk ploteson numrin përcaktuar në kërkesën e autoritetit kontraktor . Në këtë fazë duhet të deklaroheshin nga operatori ekonomik referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe kërkesës së autoritetit kontraktor numri i punonjësve të disponueshëm dhe të jepej informacioni i saktë dhe i vlefshëm. Në përfundim të analizës së fakteve komisioni i vlersimit të

ofertave arrin në konkluzionin se nga të dhënat e plotësuar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit për numrin e punonjësve nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim pika 2.3.5 dhe konsiderohet i parregullt.

**5. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik” pika 2.3.6, përcaktohet kriteri si më poshtë:**

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës, të pajisur me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/liçensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Shkurt 2023 - Prill 2023 dhe në vazhdim, minimumi:

- 1 (një) punonjës teknik ndërtimi
- 2 (dy) punonjës elektrikistë
- 4 (katër) punonjës muratorë/suvatues
- 6 (gjashtë) punonjës bojaxhi
- 1 (një) punonjës specialist për punime duralumini
- 2 (dy) punonjës pllakashtrues
- 2 (dy) punonjës për punime gipsi
- 2 (dy) punonjës hidroizolues

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë/certifikatë e arsimit profesional);
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shkurt 2023 - Prill 2023.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik “Ndërtimi” sh.p.k. nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit punonjës teknik Ndërtimi dhe punonjës elektriciste.

Ne lidhje me numrin e punonjësve të tjerë pjesë e stafit teknik ka deklaruar si më poshtë:

Punonjës muratore janë deklaruar 2 nga 4 të kërkuar

Punonjës bojaxhinj është deklaruar 1 nga 6 të kërkuar

Punonjës për punime gipsi është deklaruar 1 nga 2 të kërkuar.

Punonjës hidroizolues është deklaruar 1 nga 2 të kërkuar

Sa me sipër komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik nuk plotëson numrin e stafit teknik për punonjësit sa më sipër duke mos plotësuar në tërësi kriterin përcaktuar sipas pikës 2.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

**6. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik” pika 2.3.7, përcaktohet kriteri si më poshtë:**

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 1(një) punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatën e trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Shkurt 2023 - Prill 2023 dhe në vazhdim, në përputhje me klauzolat e Ligjit nr.10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për punonjësin e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente certifikuese të akredituara/liçensuara.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.7) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Ndërtimi” sh.p.k. konstatohet se nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit punonjës i cili të jetë i pajisur me çertifikatën e trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.7.

**7. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik” pika 2.3.8, përcaktohet kriteri si më poshtë:**

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) punonjës i cili të jetë pajisur me çertifikatën e trajnimit “Për punimet në lartësi” ose ekuivalente, në përputhje me klauzolat e Ligjit nr.10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier” dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Shkurt 2023 - Prill 2023 dhe në vazhdim. Për punonjësën e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente certifikuese të akredituara/ liçensuara.

*Shënim: Ky kriter (2.3.8) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Ndërtimi” sh.p.k. konstatohet se ky operator ekonomik nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit punonjës i cili të jetë i pajisur me çertifikatën e trajnimit “Për punimet në lartësi” ose ekuivalente duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.8.

**8. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.9, përcaktohet kriteri si më poshtë:**

**2.3.9** Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues për materialet (*bojë akrilike, bojë plastike, stuko, llaç i gatshëm, kartonxhes, kabull elektrik 3x1.5, katrama, tjegulla*), të pasqyruara në Shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, duhet të paraqesë: Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve të prodhuesit/ distributorëve zyrtarë ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit/ distributorët zyrtarë, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mallrave sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

*Shënim: Ky kriter (2.3.9) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga*

*Autoritetit Kontraktor. Nga verifikimi në Sistemin e prokurimit elektronik të Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit shtojca 8 të paraqitur nga operatori ekonomik Ndërtimi shpk si dhe nga verifikimi i dokumentacionit në tërësi konstatohet se në lidhje me këtë kriter nuk ka vetdeklaruar në shtojcën 8 dhe nuk ka bërë asnjë deklaratë të administratorit ku të japë informacion apo të deklarojë nën përgjegjësinë e tij se mallrat të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.*

*Sa më sipër operatori ekonomik nuk plotëson kriterin sipas pikës 2.3.9 të përcaktuar në kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik.*

**9. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.11, përcaktohet kriteri për makineritë si më poshtë:**

**2.3.11** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion për posedimin e mjeteve/ pajisjeve teknike dhe mbrojtëse në pronësi ose me qira, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, minimumi për mjetet/ pajisjet teknike dhe mbrojtëse si më poshtë;

Nr.	Kreu I - Mjetet dhe pajisjet teknike	Sasia minimale	Gjendja
1	Kamion 3.5 -5ton	2 copë	Pronësi ose me qira
2	Vinç kullë ≥ 16m	1 copë	Pronësi ose me qira
3	Skeleri metalike	500 m2	Pronësi ose me qira
4	Vinç karrel	1 copë	Pronësi ose me qira
5	Gjenerator ≥ 5kë	1 copë	Pronësi ose me qira
6	Depozitë uji 1000-3000lt	1 copë	Pronësi ose me qira
Nr.	Kreu II - Mjetet dhe pajisjet mbrojtëse	Sasia minimale	Gjendja
1	Helmetë mbrojtëse për kokën	92 copë	Pronësi ose me qira
2	Jelekë me shirita fosforishentë	92 copë	Pronësi ose me qira
3	Fikëse zjarri të lëvizshme ≥ 5kg	4 copë	Pronësi ose me qira
4	Tabela Sigurimi Teknik	16 copë	Pronësi ose me qira
5	Kuti e Ndhmës së shpejtë	4 copë	Pronësi ose me qira

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), kurse për mjetet e siguruar me qira duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qirasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*).
- b) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qira të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënsit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.
- c) Mjetet, pajisjet teknike dhe mjetet mbrojtëse të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas Shtojcës

8. (*Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohe dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi*).

**Shënim:Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 te**

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

*Nga verifikimi në Sistemin e prokurimit elektronik te Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit shtojca 8 të paraqitur nga operatori ekonomik Ndërtimi shpk konstatohet se në lidhje me këtë kriter nuk ka vetdeklaruar në shtojcën 8 asnjë makineri në dispozicion të Autoritetit Kontraktor për realizimin e kontratës.*

*Gjithashtu nuk ka bërë deklaratën nga administratori i shoqërisë ku të deklaroje se mjetet nuk do jenë të angazhuara ne kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës sipas pikës 2.3.11, germa ( c).*

*Sa më sipër operatori ekonomik nuk ploteson në tërësi kriterin sipas pikës 2.3.11 të përcaktuar në kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik.*

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale



e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “NDËRTIMI” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura duke e shpallur ofertë të pavalleshme.

### III. Operatori ekonomik “RAFIN COMPANY” shpk

NIPT- K11325002C

#### 1. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”

##### pika 2.3.6, përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës, të pajisur me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/liçensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Shkurt 2023 - Prill 2023 dhe në vazhdim, minimumi:

- 1 (një) punonjës teknik ndërtimi
- 2 (dy) punonjës elektrikistë
- 4 (katër) punonjës muratorë/suvatues
- 6 (gjashtë) punonjës bojaxhi
- 1 (një) punonjës specialist për punime duralumini
- 2 (dy) punonjës pllakashtrues
- 2 (dy) punonjës për punime gipsi
- 2 (dy) punonjës hidroizolues

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë/certifikatë e arsimit profesional);
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shkurt 2023 - Prill 2023.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik “Rafin Company” sh.p.k. ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit numër të punonjësve si më poshtë:

Punonjës bojaxhi janë deklaruar 4 nga 6 të kërkuar

Punonjës për punime gipsi është deklaruar 1 nga 2 të kërkuar.

Autoriteti kontraktor në hartimin e këtij kriteri kualifikues ka kërkuar që të plotësohet me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Pra, kriteri i sipërcituar duhet të përmbushej nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST, cka operatori ekonomik ka dështuar ta provojë.

Sa me sipër komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik nuk ploteson numrin e stafit teknik per punonjës bojaxhi dhe punonjës për punime gipsi duke mos plotësuar në tërësi kriterin përcaktuar sipas pikës 2.3.6 të kriterëve të vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

**2. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.3.9, përcaktohet kriteri si më poshtë:**

**2.3.9** Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specififikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues për materialet (*bojë akrilike, bojë plastike, stuko, llaç i gatshëm, kartonxhes, kabull elektrik 3x1.5, katrama, tjegulla*), të pasqyruara në Shtojcën 5 “Formulari i specififikimeve teknike”, duhet të paraqesë: Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve të prodhuesit/distributorëve zyrtarë ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit/ distributorët zyrtarë, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mallrave sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.**Shënim:** Ky kriter (2.3.9) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimin dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni

provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Nga verifikimi në Sistemin e prokurimit elektronik të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit shtojca 8 të paraqitur nga operatori ekonomik Rafin Company shpk si dhe nga verifikimi i dokumentacionit në tërësi konstatohet se në lidhje me këtë kriter nuk ka vetëdeklaruar në shtojcën 8 dhe nuk ka bërë asnjë deklaratë të administratorit ku të japë informacion apo të deklarojë nën përgjegjësinë e tij se mallrat të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër operatori ekonomik nuk ploteson kriterin sipas pikës 2.3.9 të përcaktuar në kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik.

**3. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 pika 2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.11/1 përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Kamion 3.5-5ton 2 copë.**

Nga verifikimi në Sistemin e prokurimit elektronik të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit shtojca 8 të paraqitur nga operatori ekonomik Rafin Company shpk konstatohet se operatori ekonomik ka deklaruar mjetin me targa AA123KX me kapacitet 4.9 ton dhe mjetin me targa AA289MO me kapacitet mbajtës 2.1 ton.

Nga ajo cka vetëdeklaruar operatori ekonomik konstatohet se njëri nga mjetet e deklaruara nuk ploteson kapacitetin mbajtës të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Pra sa me sipër vetem njëri nga mjetet është konform kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

**4. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 pika 2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.11/ Kreu II/2 përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Jelekë me shirita fosforishentë 92 copë.**

Nga verifikimi në Sistemin e prokurimit elektronik të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit shtojca 8 të paraqitur nga operatori ekonomik Rafin Company shpk konstatohet se operatori ekonomik nuk ka deklaruar se disponon jelekë me shirita fosforishentë.

Pra sa me sipër operatori ekonomik nuk plotëson kriterin përcaktuar në kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti Teknik pika 2.3.11/ Kreu II/2.

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën,

siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “Rafin Company” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion te plotë në përputhje me kriteret e vendosura duke e shpallur ofertë të pavlefshme.

#### **IV. Operatori ekonomik “UDHA” shpk**

**NIPT- K77524909Q**

##### **1. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e vecanta për kualifikim”, pika 2.3.5 përcaktohet kriteri si më poshtë:**

**2.3.5** Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **92 (nëntëdhjetë e dy) punonjës** për periudhën 3(tre) muaj **Shkurt 2023–Prill 2023**. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- c) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën **Shkurt 2023–Prill 2023**.
- d) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Shkurt 2023–Prill 2023**.

***Shënim:** Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

*Nga verifikimi në Sistemin e prokurimit elektronik te Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit shtojca 8 të paraqitur nga operatori ekonomik UDHA shpk konstatohet se operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 87.5 punonjës duke mos plotësuar numrin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit prej 92 punonjës.*

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se informacioni që duhet të përmbajë formulari përmbledhës i vetëdeklarimit duhet të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave pas shqyrtimit të vetëdeklarimit të bërë nga operatori ekonomik në lidhje me numrin e punonjësve të cilët do ti vihen në dispozicion autoritetit kontraktor për realizimin e kontratës konstaton se operatori ekonomik nuk plotëson numrin përcaktuar në kërkesën e autoritetit kontraktor . Në këtë fazë duhet të deklaroheshin nga operatori ekonomik referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe kërkesës së autoritetit kontraktor numri i punonjësve të disponueshëm dhe të jepej informacion i saktë dhe i vlefshëm. Në përfundim të analizës së fakteve komisioni i vlersimit të ofertave arrin në konkluzionin se nga të dhënat e plotësuar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit për numrin e punonjësve nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim pika 2.3.5 dhe konsiderohet i parregullt.

##### **2. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik” pika 2.3.6, përcaktohet kriteri si më poshtë:**

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës, të pajisur me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/liçensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Shkurt 2023 - Prill 2023 dhe në vazhdim, minimumi:

- 1 (një) punonjës teknik ndërtimi
- 2 (dy) punonjës elektrikistë

- 4 (katër) punonjës muratorë/suvatues
- 6 (gjashtë) punonjës bojaxhi
- 1 (një) punonjës specialist për punime duralumini
- 2 (dy) punonjës pllakashtrues
- 2 (dy) punonjës për punime gipsi
- 2 (dy) punonjës hidroizolues

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë/certifikatë e arsimit profesional);
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shkurt 2023 - Prill 2023.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik "UDHA" sh.p.k. nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit asnjë punonjës për punime gipsi nga 2 të kërkuar.

Ne lidhje me numrin e punonjësve të tjerë pjesë e stafit teknik ka deklaruar si më poshtë:

Punonjës muratore janë deklaruar 3 nga 4 të kërkuar

Punonjës bojaxhinj janë deklaruar 2 nga 6 të kërkuar

Punonjës hidroizolues është deklaruar 1 nga 2 të kërkuar

Sa me sipër komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik nuk ploteson numrin e stafit teknik për punonjësit sa më sipër duke mos plotësuar në tërësi kriterin përcaktuar sipas pikës 2.3.6 të kriterëve të vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

### 3. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", "Kapaciteti Teknik" pika 2.3.8, përcaktohet kriteri si më poshtë:

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) punonjës i cili të jetë pajisur me certifikatën e trajnimit "Për punimet në lartësi" ose ekuivalente, në përputhje me klauzolat e Ligjit nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier" dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Shkurt 2023 - Prill 2023 dhe në vazhdim. Për punonjësën e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente certifikuese të akredituara/ licensuara.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.8) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "UDHA" sh.p.k. konstatohet se ky operator ekonomik nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatën e trajnimit "Për punimet në lartësi" ose ekuivalente duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.8.

### 4. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.3.9, përcaktohet kriteri si më poshtë:

**2.3.9** Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues për materialet (bojë akrilike, bojë plastike, stuko, llaç i gatshëm, kartonxhes, kabull elektrik 3x1.5, katrama, tjegulla), të pasqyruara në Shtojcën 5 "Formulari i specifikimeve teknike", duhet të paraqesë: Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve të prodhuesit/ distributorëve zyrtarë ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit/ distributorët zyrtarë, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mallrave sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara të cilat

do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.9) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Nga verifikimi në Sistemin e prokurimit elektronik të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit shtojca 8 të paraqitur nga operatori ekonomik UDHA shpk si dhe nga verifikimi i dokumentacionit në tërësi konstatohet se në lidhje me këtë kriter nuk ka vetëdeklaruar në shtojcën 8 dhe nuk ka bërë asnjë deklaratë të administratorit ku të japë informacion apo të deklarojë nën përgjegjësinë e tij se mallrat të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër operatori ekonomik nuk plotëson kriterin sipas pikës 2.3.9 të përcaktuar në kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik.

**5. Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.11, përcaktohet kriteri për makineritë si më poshtë:**

**2.3.11** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion për posedimin e mjeteve/ pajisjeve teknike dhe mbrojtëse në pronësi ose me qira, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, minimumi për mjetet/ pajisjet teknike dhe mbrojtëse si më poshtë;

Nr.	Kreu I - Mjetet dhe pajisjet teknike	Sasia minimale	Gjendja
1	Kamion 3.5 -5ton	2 copë	Pronësi ose me qira
2	Vinç kullë $\geq 16m$	1 copë	Pronësi ose me qira
3	Skeleri metalike	500 m <sup>2</sup>	Pronësi ose me qira
4	Vinç karrel	1 copë	Pronësi ose me qira
5	Gjenerator $\geq 5kë$	1 copë	Pronësi ose me qira
6	Depozitë uji 1000-3000lt	1 copë	Pronësi ose me qira
Nr.	Kreu II - Mjetet dhe pajisjet mbrojtëse	Sasia minimale	Gjendja
1	Helmetë mbrojtëse për kokën	92 copë	Pronësi ose me qira
2	Jelekë me shirita fosforishentë	92 copë	Pronësi ose me qira
3	Fikëse zjarri të lëvizshme $\geq 5kg$	4 copë	Pronësi ose me qira
4	Tabela Sigurimi Teknik	16 copë	Pronësi ose me qira
5	Kuti e Ndihmës së shpejtë	4 copë	Pronësi ose me qira

- d) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), kurse për mjetet e siguruar me qira duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qirasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*).
- e) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qira të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënsit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.
- f) Mjetet, pajisjet teknike dhe mjetet mbrojtëse të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon

të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Shtojcës 8. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).

**Shënim:Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 te**

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

*Nga verifikimi në Sistemin e prokurimit elektronik te Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit shtojca 8 të paraqitur nga operatori ekonomik UDHA shpk konstatohet se në lidhje me këtë kriter nuk ka vetëdeklaruar në shtojcën 8 në dispozicion të autoritetit kontraktor makineritë sa më poshtë:*

- Kamion me 3.5-5 Ton                      2 copë
- Vinc kulle                                      1 copë
- Vinc karrel                                     1 copë
- Gjenerator                                    1 copë
- Depozite uji.                                 1 copë

*Gjithashtu nuk ka bërë deklaratën nga administratori i shoqërisë ku të deklarohet se mjetet nuk do jenë të angazhuara ne kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës sipas pikës 2.3.11, germa ( c).*

*Sa më sipër operatori ekonomik nuk ploteson në tërësi kriterin sipas pikës 2.3.11 të përcaktuar në kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik.*

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “UDHA” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion te plotë në përputhje me kriteret e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

**V. Operatori ekonomik “INERTI” shpk**

**NIPT- J66926804L**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82 pika 4 u bë përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët. Nga përlllogaritja rezultoi se oferta e operatorit ekonomik “INERTI” shpk të kualifikuar dhe të renditur në vend të parë vlerësohet si ofertë anomalisht e ulët.

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave i ka kërkuar operatorit ekonomik “INERTI” shpk të paraqesë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme brenda datës 21.06.2023, ora 16:00 shpjegime për elementët e veçantë të ofertës sipas përcaktimeve të Nenit 93 pika 1, të Kreut XI të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin Publik”.

Komisioni i vlerësimit të ofertave nga verifikimi i sistemit të prokurimit elektronik dhe i protokollit të institucionit vëren se brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor nga ana e ofertuesit nuk është

paraqitur dokumentacion shpjegues në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Operatori ekonomik ka detyrimin ligjor që të prezantojë me dokumentacion provues zgjidhjet teknike dhe/ose ndonjë kusht favorizues, që do të garantonin realizimin e punës sipas standardeve të kërkuara në cilësi dhe volum dhe me çmimin konkurrues të ofertuar pranë autoritetit kontraktor. Bazuar në sa më lart, Komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, nuk janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinalitetit të punës së propozuar), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht Komisioni i vlerësimit të ofertave në respekt të nenit 93 të LPP-së dhe të pikës 4 të Nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 **vendos skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “INERTI” shpk**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **bashkimin e operatorëve ekonomik “I 2 A” shpk & “VALONA KONSTRUKSION” shpk me adresë** Njësia administrative Bërxullë Zona Kadastrale Nr. 1167, Pasuria Nr.700 Tirane, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 32.402.654 (tridhjetë dymilion e katërqind e dymijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër) lek pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme me Adresë: Rruga “Jeronim De Rada”, pranë shkollës Teknike Ekonomike, Tirane sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesw) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 34.890.051 (tridhjetë e katërmilion e tetëqind e nëntëdhjetëmijë e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_